



**USAID**

NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



# PULSI PUBLIK

## XX

Maj 2021



Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të të anketuarve dhe nuk i përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP-së dhe USAID-it.

# Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	7
Treguesit kyç të Pulsit Publik	9
Drejtimi politik i Kosovës	10
Siguria personale	12
Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike	13
Drejtimi ekonomik	17
Problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht	18
Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat	20
Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë	22
Qëndrimet kundrejt votimit	25
Mjedisi	29
COVID-19	32
Metodologjia	36
Peshimi i totaleve të popullatës	36
Përlllogaritja e indekseve	37

# Lista e tabelave

Tabela 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë	10
Tabela 2 Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së	15
Tabela 3 Analiza e trendeve të komponentëve të IBE-së	16
Tabela 4 Perceptimet për përhapjen e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë	23

# Lista e figurave

Figura 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës	11
Figura 2 Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike	12
Figura 3 Perceptimi i të anketuarve për sigurinë	13
Figura 4 Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike	13
Figura 5 Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës	17
Figura 6 Perceptimet për problemet madhore me të cilat përballlet Kosova aktualisht	19
Figura 7 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik	21
Figura 8 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat	22
Figura 9 Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre për shtrirjen e korrupsionit në Kosovë	24
Figura 10 Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	25
Figura 11 Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	26
Figura 12 Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	27
Figura 13 Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse zgjedhjet qendrore mbahen së shpejti	27
Figura 14 Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, të dhëna të zërthyerë sipas përkatësisë etnike	28
Figura 15 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër	29
Figura 16 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të dhëna të zërthyerë sipas përkatësisë etnike	30
Figura 17 Vetëdija e të anketuarve për kërcënimet potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre	31
Figura 18 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, të dhëna të zërthyerë sipas përkatësisë etnike	32
Figura 19 Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor	33
Figura 20 Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor, të dhëna të zërthyerë sipas përkatësisë etnike	34
Figura 21 Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19	35
Figura 22 Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19, të dhëna të zërthyerë sipas përkatësisë etnike	35



# Përmbledhje ekzekutive

Përmbledhja e Pulsit Publik ofron një pasqyrë të gjetjeve të dhjetë treguesve kyç që nxirren nga anketat e opinionit publik të cilat kryhen dy herë në vit me të anketuarit në Kosovë.<sup>1</sup> Kjo Përmbledhje e 20-të e Pulsit Publik bazohet në anketën e realizuar nga data 12 deri 25 maj 2021, me 1,307 të anketuar nga të gjitha komunitetet etnike në Kosovë. Të dhënat dhe treguesit nga anketa e opinionit publik zërthehen sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë në mënyrë që të sigurohen informata të detajuara mbi dallimet në perceptime dhe problemet zhvillimore me të cilat përballen qytetarët në Kosovë.

Gjetjet e anketës së opinionit të Pulsit Publik të majit 2021 tregojnë një rritje domethënëse të kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e institucioneve kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore të Kosovës, krahasuar me anketën e mëparshme të realizuar në dhjetor 2020. Kënaqshmëria e regjistruar me performancën e kabinetit të ekzekutivit është 59.1%, gjë që përbën një rritje prej 37.8 pikë përqindje në krahasim me anketën e dhjetorit 2020 kur kjo vlerë ishte 21.3%. Për më tepër, niveli i regjistruar i kënaqshmërisë me punën e Kryeministrit është 59.5% (23% në dhjetor 2020), ndërsa kënaqshmëria me punën e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës është rritur nga 46.7% në dhjetor 2020 në 59.2% në maj 2021. Niveli më i lartë i kënaqshmërisë prej 63.7% është regjistruar me punën e Presidentes së Kosovës, krahasuar me 33.9% të regjistruar në dhjetor 2020. Indeksi i Demokratizimit (ID) është rritur me 0.26 pikë (1.58) krahasuar me dhjetorin 2020, kur kjo vlerë ishte 1.32 pikë. Edhe Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE) është rritur nga dhjetori 2020 (0.84) dhe ka arritur në 1.49 pikë, duke treguar një rritje të konsiderueshme të besimit të qytetarëve në perspektivën ekonomike të Kosovës. Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja maten në një shkallë nga 0 pikë (minimumi) në 3 pikë (maksimumi), ku vlerat nën 1.5 konsiderohen negative, ndërsa ato mbi 1.5 tregojnë qëndrim pozitiv të shumicës së qytetarëve në lidhje me indekset e demokratizimit dhe ekonomisë.

Një numër pak më i lartë i të anketuarve janë të gatshëm të protestojnë për arsye politike sesa në dhjetor 2020. Gjithsej 36.7% e të anketuarve do të ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike në maj 2021, krahasuar me 30.6% në dhjetor 2020. Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë rritje të gatishmërisë për të protestuar tek 39.5% të shqiptarëve të Kosovës (31.2% në dhjetor 2020), 23.3% të serbëve të Kosovës (19.2% në dhjetor 2020), dhe 32.3% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (26.9% në dhjetor 2020) (boshnjakë të Kosovës, ashkali të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës). Ndërkohë që pjesa më e madhe e serbëve të Kosovës (47.6%) janë indiferentë në lidhje me drejtimin politik të Kosovës, 35.7% e shqiptarëve të Kosovës janë të pakënaqur me drejtimin aktual politik krahasuar me 60.6% në dhjetor 2020, ndërsa 37.3% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës.

Gjetjet nga anketa e Pulsit Publik XX tregojnë edhe rritje thelbësore të ndjenjës së sigurisë tek të anketuarit, me 76.4% që ndihen të sigurt kur janë jashtë (në publik), krahasuar me 68.4% të regjistruar në dhjetor 2020. Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë tregojnë se ndjenja e sigurisë është pothuajse e njëjtë për femrat (76.7%) dhe meshkujt (76%). Ndjenja e sigurisë në mesin e serbëve të Kosovës është ulur me 11.3 pikë përqindjeje, me 34.8% që ndihen të sigurt në maj 2021

<sup>1</sup> Për UNDP-në, referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

krahasuar me 46.1% në dhjetor 2020. Ndjenja më e lartë e sigurisë është regjistruar në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, me 85% që ndihen të sigurt kur janë jashtë.

Anketa e Pulsit Publik e majit 2021 hulumtoi edhe problemet më madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht. Gjetjet tregojnë një ndryshim nga anketa e mëparshme në tre çështjet madhore që ndikojnë në mirëqenien sociale, me korrupsionin që i ka zëvendësuar problemet e hapësirës urbane. Tre çështjet kryesore madhore të raportuara gjatë kësaj ankete ishin papunësia (34.3%), varfëria (19.3%) dhe korrupsioni (9.3%), ndërkohë që papunësia, varfëria dhe problemet e hapësirës urbane ishin tre shqetësimet kryesore në dhjetor 2020. Krahasuar me prillin e vitit 2020, korrupsioni (23.5%) ka rënë me 14.2 pikë përqindjeje. Serbët e Kosovës e konsiderojnë papunësinë (16.7%), sigurinë publike dhe personale (14.8%) dhe problemet e hapësirës urbane (12.9%) si tre problemet më të mëdha, ndërsa për komunitetet e tjera të Kosovës problemi më i madh është papunësia (51.2%), ndjekur nga varfëria (18.9%) dhe furnizimi me energji (11.4%). Për shqiptarët e Kosovës, papunësia (33.7%), varfëria (19.6%) dhe korrupsioni (9.6%) janë tre problemet madhore në Kosovë. Gjithsej 76% e të anketuarve konsiderojnë së punësimi në institucionet publike në Kosovë nuk bëhet në baza meritore, krahasuar me dhjetorin 2020 kur këtë e besonin 78.1% e të anketuarve. Mesatarisht, 25% e të anketuarve pohojnë se perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, gjë që paraqet një rënie prej 3 pikë përqindjeje nga dhjetori 2020, por një rritje prej 4.3 pikë përqindjeje nga prilli 2020 (20.7) kur nga anketa e Pulsit Publik u regjistrua perceptim më i ulët për korrupsionin në shkallë të gjerë.

Sa i përket të drejtës për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, gjithsej 16.1% thanë se dinë shumë për këtë temë, 32.7% pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 36% e të anketuarve thanë se kanë pak njohuri për këtë temë. Gjithsej 15.2% thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, një rënie prej 12.2 pikë përqindjeje nga dhjetori 2020 (27.4%).

Kjo përmbledhje ofron të dhëna edhe mbi qëndrimet e popullit të Kosovës ndaj votimit, të dhëna mbi ndikimin e COVID-19 në mirëqenien ekonomike, shëndetin fizik dhe shëndetin mendor të të anketuarve, si dhe për kënaqshmërinë e tyre me masat e ndërmarra nga institucionet e Kosovës për ta parandaluar përhapjen e COVID-19. Të dhënat shtesë të marra përmes kësaj ankete do të vihen në dispozicion përmes [Platformës për Vizualizimin e të Dhënave të Pulsit Publik dhe ASKData](#).<sup>2</sup> UNDP-ja po e mbështet në nivel global luftën kundër pandemisë dhe po zhvillon intervenime specifike sipas shteteve për t'i adresuar nevojat e vendeve ku kjo organizatë funksionon. Në Kosovë, UNDP-ja i ka zhvilluar tre vlerësime të ndikimit socio-ekonomik të pandemisë COVID-19 për ta ndihmuar Kosovën dhe institucionet ndërkombëtare në reagimin ndaj sfidave të shkaktuara nga kriza e COVID-19.

<sup>2</sup> Platforma për Vizualizimin e të Dhënave: <http://unk.org/public-pulse/>. ASKData është platformë e Agjencisë së Statistikave të Kosovës



# Treguesit kyç të Pulsit Publik

Rezultatet e anketës së Pulsit Publik të majit 2021 tregojnë një rritje thelbësore të niveleve të kënaqshmërisë së qytetarëve me të gjitha institucionet e Kosovës krahasuar me anketën e opinionit të zhvilluar në dhjetor të vitit 2020. Mesatarisht, 51.4% e të anketuarve janë të kënaqur me punën e institucioneve qendrore të Kosovës krahasuar me 27.5% në dhjetor 2020 dhe 42.5% në prill 2020.<sup>3</sup> Kjo e përfaqëson shkallën më të lartë të kënaqshmërisë me punën e institucioneve qendrore të Kosovës të regjistruar ndonjëherë nga Pulsit Publik.

Konkretisht, kënaqshmëria me punën e Presidentes së Kosovës (63.7%) është rritur me 29.2 pikë përqindjeje nga dhjetori i vitit 2020 kur u regjistrua në nivelin prej 33.9%. Kënaqshmëria me punën e Kryeministrit (59.5%) është rritur me 36.5 pikë përqindjeje krahasuar me dhjetorin 2020, kur u regjistrua në nivelin prej 23%, por është më e ulët se në prill 2020, kur u regjistrua në nivelin prej 65.4%. Kënaqshmëria me kabinetin ekzekutiv (59.1%) është rritur për 37.8 pikë përqindjeje krahasuar me dhjetorin e vitit 2020, kur kjo vlerë ishte në 21.3%. Niveli i kënaqshmërisë me Kryetarin e Kuvendit (59.2%) është rritur për 12.5 pikë përqindjeje krahasuar me dhjetorin 2020 kur kjo vlerë ishte 46.7%, por është 13.2 pikë përqindjeje më e ulët se në prill të vitit 2020. Kënaqshmëria me punën e Kuvendit të Kosovës (52.9%) është rritur për 30.3 pikë përqindjeje krahasuar me dhjetorin 2020 kur ishte 22.6%. Vlen të përmendet se niveli i kënaqshmërisë me punën e Kuvendit të Kosovës është 19.5 pikë përqindjeje më i lartë se në prill të vitit 2020 (33.4%).

Rritje të ngjashme të niveleve të kënaqshmërisë janë regjistruar për shumicën e institucioneve të tjera. Për shembull, gjykatat kanë arritur nivelet më të larta të kënaqshmërisë të regjistruara ndonjëherë nga Pulsit Publik me 34.6% të të anketuarve që janë të kënaqur me punën e gjykatave. Në dhjetor dhe prill të vitit 2020, kënaqshmëria me gjykatat ishte 23%, përkatësisht 24.8%. Niveli i kënaqshmërisë me Zyrën e Prokurorit (30.8%) është më i larti që nga nëntori i vitit 2018 (35.3%) dhe është më i lartë se në dhjetor të vitit 2020 (23%) dhe në prill të vitit 2020 (22.3%). Të dyja institucionet tregojnë një rritje të qëndrueshme të kënaqshmërisë krahasuar me nëntorin e vitit 2019 (përkatësisht, 13.6% dhe 14.2%) dhe majin e vitit 2019 (përkatësisht, 18.7% dhe 16.4%).

<sup>3</sup>Gjatë vitit të kaluar Kosova pati tre kabinete të ndryshme qeveritare: pas votimit të mocionit të mosbesimit më 25 mars 2020 për kabinetin ekzekutiv të udhëhequr nga z. Albin Kurti, kabineti i ri ekzekutiv i udhëhequr nga z. Avdullah Hoti u votua më 3 qershor 2020. Kabineti i ri i udhëhequr nga z. Kurti u zgjodh nga Kuvendi i Kosovës më 22 mars 2021, pas zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura më 14 shkurt 2021.

**Tabela 1. Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë**

Treguesit Politik	Mars -15	Shta -15	Prill -16	Tet -16	Tet -17	Maj -18	Nën -18	Maj -19	Nën -19	Prill -20	Dhje -20	Maj -21	Trendi	
Kënaqshmëria me ekzekutivin	Qeveria	18.10%	17.30%	17.80%	20.20%	32.40%	30.00%	31.30%	17.70%	14.40%	60.70%	21.30%	59.10%	
	Kryeministri	23.60%	14.60%	18.30%	19.70%	42.30%	33.20%	35.10%	36.50%	20.70%	65.40%	23.00%	59.50%	
Kënaqshmëria me legjislativin	Kuvendi	19.30%	19.90%	17.30%	18.90%	31.70%	32.90%	36.10%	19.60%	18.60%	33.40%	22.60%	52.90%	
	Kryetari i Kuvendit	20.10%	19.80%	24.30%	24.90%	36.00%	31.50%	36.30%	23.60%	20.50%	72.40%	46.70%	59.20%	
Kënaqshmëria me presidentin	Presidenti	30.20%	30.40%	45.70%	25.50%	37.60%	39.10%	38.40%	20.40%	21.20%	18.70%	33.90%	63.70%	
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	17.20%	13.90%	18.40%	22.10%	36.90%	31.20%	37.80%	18.70%	13.60%	24.80%	23.00%	34.60%	
	Prokuroria	17.00%	12.80%	16.90%	16.30%	33.10%	29.90%	35.30%	16.40%	14.20%	22.30%	23.00%	30.80%	

## Drejtimi politik i Kosovës

Numri i qytetarëve që janë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës është rritur për gati dyfish krahasuar me anketën e opinionit të kryer në dhjetor të vitit 2020 dhe paraqet nivelin më të lartë të kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës të regjistruar ndonjëherë nga anketat e Pulsit Publik. Gjithsej 24.7% janë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës për dallim nga 13.4% në dhjetor të vitit 2020 dhe 10.6% në prill të vitit 2020. Në këtë mënyrë, është ulur ndjeshëm numri i atyre që nuk janë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës, duke e treguar kështu nivelin më të ulët të pakënaqësisë të regjistruar ndonjëherë nga anketat e opinionit të Pulsit Publik, me 36.4% të pakënaqur në krahasim me 59.4% në dhjetor të vitit 2020 dhe 69.6% në prill të vitit 2020. Sidoqoftë, janë shtuar edhe ata që janë indiferent në lidhje me drejtimin politik të Kosovës, me 38.8% që janë neutral kundrejt 27.2% në dhjetor të vitit 2020 dhe 19.7% në prill të vitit 2020.

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se meshkujt janë më të kënaqur (25.5%) me drejtimin politik të Kosovës sesa femrat (24%). Në të njëjtën kohë, përqindja e meshkujve të pakënaqur (38.5%) me drejtimin politik të Kosovës është dukshëm më e lartë se ajo e femrave (33.7%). Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se niveli më i lartë i kënaqshmërisë gjendet tek pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (37.3%), ndjekur nga

shqiptarët e Kosovës (27.9%) dhe serbët e Kosovës (9.1%). Në këtë mënyrë, niveli më i lartë i pakënaqësisë gjendet tek serbët e Kosovës (42.8%), ndjekur nga shqiptarët e Kosovës (35.7%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (27.8%). Përqindja e atyre që janë neutral është mjaft e lartë, me 47.6% të serbëve të Kosovës, 35.7% të shqiptarëve të Kosovës dhe 34.8% të komuniteteve të tjera të Kosovës që janë neutral në vlerësimin e tyre të drejtimit politik të Kosovës.




Figura 1. Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës

Gjithsej 36.7% e të anketuarve janë të gatshëm të marrin pjesë në protesta politike, gjë që paraqet një rritje të vogël krahasuar me dhjetorin e vitit 2020 (30.6%), prillin e vitit 2020 (33.6%) dhe nëntorin e vitit 2019 (31.3%), por tregon rënie nga maji i vitit 2019 (42.2%). Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se shqiptarët e Kosovës janë më të gatshëm të protestojnë sesa serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës. Konkretisht, 39.5% e shqiptarëve të Kosovës janë të gatshëm të protestojnë, kundrejt 23.3% të serbëve të Kosovës dhe 32.3% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Krahasuar me dhjetorin e vitit 2020, gatishmëria për të protestuar për arsye politike është më e lartë tek të gjitha komunitetet, përfshirë shqiptarët e Kosovës (31.3%), serbët e Kosovës (19.5%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (26.5%).




Figura 2. Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike

## Siguria personale

Për t'a matur perceptimin për sigurinë publike, të anketuarit u pyetën nëse ndihen të sigurt apo të pasigurt kur janë jashtë në rrugë në aspektin e dhunës dhe krimit potencial. Gjetjet tregojnë një rritje prej 8 pikë përqindjeje të nivelit të sigurisë (76.4%) krahasuar me dhjetorin e vitit 2020 (68.4%), por edhe rënie krahasuar me prillin e vitit 2020 kur u regjistrua niveli më i lartë i sigurisë me 86.3% të të anketuarve që ndiheshin të sigurt në rrugët e Kosovës.





Figura 3. Perceptimi i të anketuarve për sigurinë

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se në perceptimin e sigurisë nuk ka dallime mes meshkujve (76%) dhe femrave (76.7%). Kjo paraqet një rritje në ndjenjën e sigurisë si për femrat ashtu edhe për meshkujt krahasuar me dhjetorin e vitit 2020, kur 68.3% e meshkujve dhe 68.5% e femrave ndiheshin të sigurt në rrugë, por një rënie në ndjenjën e sigurisë krahasuar me prillin e vitit 2020 kur 85.4% e meshkujve dhe 87.2% e femrave ndiheshin të sigurt në rrugë. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime më të mëdha, ku 85% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 76.4% e shqiptarëve të Kosovës ndihen të sigurt kur janë në rrugë, kundrejt 34.8% të serbëve të Kosovës që ndihen të sigurt në rrugë. Ndjenja e sigurisë në mesin e serbëve të Kosovës ka rënë për 12.2 pikë përqindjeje krahasuar me dhjetorin e vitit 2020 (47%) dhe është më e ulët se në prill të vitit 2020 (46.2%).

## Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike

Në përputhje me trendet rritëse, anketa e Pulsit Publik e majit të vitit 2021 ka regjistruar një rritje të Indeksit të Demokratizimit (ID) dhe Indeksit të Besueshmërisë Ekonomike (IBE), ku të dyja këto indekse i kanë arritur vlerat më të larta të regjistruara ndonjëherë nga Pulsit Publik.<sup>4</sup> Më konkretisht, ID-ja aktuale ka kapur vlerën 1.58, e cila është 0.25 pikë më e lartë sesa në dhjetor të vitit 2020 (1.32) dhe 0.08 pikë më e lartë sesa në prill të vitit 2020 (1.53). Kjo shifër sugjeron se më shumë se gjysma e qytetarëve në Kosovë kanë pikëpamje pozitive për proceset demokratike në Kosovë.

Një rritje e ngjashme mund të vërehet në IBE, që është rritur nga vlera prej 0.84 në dhjetor të vitit 2020 duke e kapur vlerën prej 1.49 pikë në maj të vitit 2021. Në prill të vitit 2020, IBE-ja ishte 0.98 pikë. Kjo shifër sugjeron se pothuajse gjysma e qytetarëve në Kosovë kanë pikëpamje pozitive për trendet ekonomike në Kosovë.



**Figura 4. Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike**

<sup>4</sup>ID-ja dhe IBE-ja janë masa të vazhdueshme nga 0 në 3, në të cilat një rezultat nga 0 në 1.5 nënkupton se shumica e popullatës e sheh negativisht demokracinë apo trendet ekonomike, dhe rezultati nga 1.5 në 3 nënkupton se shumica e popullatës e sheh pozitivisht demokratizimin ose trendet ekonomike.

Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja përbëhen nga një numër komponentësh që përdoren për t'i gjeneruar indekset përkatëse. ID-ja përbëhet nga nëntë komponentë të paraqitur në Tabelën 2 më poshtë. Pyetjeve që bien brenda fushëveprimit të këtij indeksi mund t'u jepen përgjigje me "Po, plotësisht", "Po, kryesisht", "Jo aq shumë", ose "Aspak". Tabela 2 tregon përqindjen e të anketuarve që u përgjigjën me "Po, kryesisht" ose "Po, plotësisht" në të nëntë pyetjet. Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në rritjen e ID-së, të dhënat nga anketa e majit të vitit 2021 u krahasuan me ato të gjeneruara në anketat e mëparshme. Gjetjet tregojnë se çdo komponent i ID-së i listuar në Tabelën 2 ka treguar rritje krahasuar me dhjetorin e vitit 2020.

Gjithsej 70.4% e të anketuarve besojnë se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe sipas standardeve ndërkombëtare, krahasuar me 45.9% në dhjetor të vitit 2020, 66.3% në prill të vitit 2020, 62.7% në nëntor të vitit 2019 dhe 35.6% në maj të vitit 2019, duke bërë që ky të jetë komponenti i ID-së me vlerësimin më të lartë. Gjithsej 60.1% e të anketuarve konsiderojnë se Kuvendi e monitoron performancën e kabinetit ekzekutiv, krahasuar me 45.6% në dhjetor të vitit 2020, 58% në prill të vitit 2020 dhe 38.6% në nëntor të vitit 2019. Komponenti i gjyqësorit ka treguar vetëm një rritje të lehtë nga 36.6% në dhjetor të vitit 2020 në 37.5% në maj të vitit 2021 dhe është më i ulët se në prill të vitit 2020 (39.7%). Komponenti i gjyqësorit e ka marrë vlerësimin më të ulët krahasuar me komponentët e tjerë të ID-së. Gjithsej 69.2% e të anketuarve konsiderojnë se media gëzon lirinë e shprehjes, krahasuar me 57.9% në dhjetor të vitit 2020 dhe 69.1% në prill të vitit 2020. Rritje është vërejtur edhe në perceptimet mbi rolin e organizatave të shoqërisë civile si monitorues të mirëfilltë të ekzekutivit, me 56.6% të të anketuarve që besojnë se kjo është e vërtetë krahasuar me 45.8% në dhjetor të vitit 2020 dhe 50.7% në prill të vitit 2020. Rritje është regjistruar edhe në perceptimet nëse institucionet lokale dhe qendrore punojnë sipas prioriteteve të popullit të Kosovës, me 52.6% dhe 54.4% përkatësisht, krahasuar me dhjetorin e vitit 2020 kur këto shifra ishin 41.5%, respektivisht 30.6%. Në prill të vitit 2020, këto shifra ishin 56.7%, respektivisht 54.9%. Një rritje e ngjashme vërehet në përgjigjet në pyetjen nëse Kushtetuta dhe ligjet në fuqi janë demokratike dhe nëse përputhen me standardet e të drejtave të njeriut, me 58.1% të të anketuarve që kanë dhënë përgjigje pozitive. Kjo paraqet një rritje prej 15.3 pikë përqindjeje nga dhjetori i vitit 2020 (42.8%), por një rënie prej 6.9 pikë përqindjeje nga prilli i vitit 2020 (64%). Për fund, vërehet një rritje e konsiderueshme prej 22.4 pikë përqindjeje krahasuar me dhjetorin e vitit 2020 (36.2%) edhe në përgjigjet në pyetjen nëse proceset demokratike në Kosovë janë vendosur dhe po shkojnë në drejtimin e duhur (58.6), duke qenë më e lartë edhe se në prill të vitit 2020 kur kjo shifër ishte 42.5%. Për ndryshim nga anketa e mëparshme e opinionit kur të trija grupet iu përgjigjën pyetjeve të komponentëve të ID-së me "aspak" dhe "jo aq shumë", të dhënat e majit 2021 të zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se teksa shumica e shqiptarëve të Kosovës dhe shumica e të anketuarve nga komunitetet e tjera të Kosovës u përgjigjën me "po plotësisht", dhe "po kryesisht" në të gjitha pyetjet përveç njëjës,<sup>5</sup> shumica e serbëve të Kosovës u përgjigjën me "aspak" dhe "jo aq shumë" në të gjitha pyetjet e komponentëve të ID-së.

<sup>5</sup>Në pyetjen për gjyqësorin, shumica e shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës u përgjigjën me "aspak" dhe "jo aq shumë".

**Tabela 2. Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së**

Po kryesisht dhe Po plotësisht	Mars -15	Shta -15	Prill -16	Tet -16	Tet -17	Maj -18	Nën -18	Maj -19	Nën -19	Prill -20	Dhje -20	Maj -21	Trendi
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	26.20%	23.00%	30.30%	28.00%	44.60%	50.90%	53.70%	35.60%	62.73%	66.30%	45.87%	70.44%	
A e monitoron Kuvendi performancën e Qeverisë?	21.20%	21.80%	26.60%	30.80%	36.10%	46.70%	48.30%	38.10%	38.61%	58.00%	45.56%	60.13%	
A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?	13.60%	17.60%	21.00%	21.60%	31.20%	43.60%	46.00%	21.50%	31.48%	39.70%	36.66%	37.50%	
A gëzon media në Kosovë lirinë e shprehjes?	35.50%	46.50%	47.30%	42.30%	52.50%	52.80%	59.10%	45.60%	46.66%	69.10%	57.94%	69.24%	
A shërben Shoqëria Civile në Kosovë si monitorues i sinqertë i zhvillimeve demokratike në Kosovë?	19.50%	23.10%	32.10%	30.10%	34.30%	48.30%	57.50%	32.60%	34.79%	50.70%	45.77%	56.56%	
A funksionon qeverisja juaj lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	23.30%	27.20%	28.90%	30.40%	34.00%	50.20%	49.20%	29.80%	29.62%	56.70%	41.53%	52.64%	
A funksionon qeveria e Kosovës sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	11.80%	15.50%	18.90%	17.90%	24.70%	39.90%	37.50%	18.10%	24.23%	54.90%	30.61%	54.39%	
A janë Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut	23.50%	19.80%	31.70%	31.80%	41.40%	53.40%	60.50%	33.40%	40.30%	64.00%	42.82%	58.07%	
Pavarësisht nga politika e përditshme dhe me vështrimin drejt të ardhmes, a pranoi se proceset demokratike në Kosovë	17.30%	15.40%	23.10%	23.80%	29.70%	46.90%	57.20%	22.40%	33.01%	42.50%	36.22%	58.65%	

Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në rritjen e IBE-së, përgjigjet aktuale pozitive për komponentët e IBE-së u krahasuan me ato të mbledhura në anketat e mëparshme, siç tregohet në Tabelën 3 më poshtë. Përgjigjet e mundshme për pyetjet që kanë të bëjnë me IBE-në janë "të favorshme", "jo të favorshme" dhe "neutrale". Gjithsej 15.9% e të anketuarve kanë pritshmëri të favorshme në lidhje me të hyrat totale të familjes brenda gjashtë muajve, duke treguar rritje prej 4.4 pikë përqindjeje nga dhjetori i vitit 2020 (11.5%) dhe rritje prej 1.7 pikë përqindjeje nga prilli i vitit 2020 (14.2%). Sidoqoftë, vërehet një rënie në mënyrën se si të anketuarit i shohin kushtet për të bërë biznes në Kosovë me vetëm 4.7% që konsiderojnë se janë të favorshme – një rënie krahasuar me 7.2% të dhjetorit të vitit 2020 dhe prillit të vitit 2020 (8.2%). Supozohet se për shkak të pandemisë, kjo shifër është gjithashtu më e ulët se në nëntor të vitit 2019 (9.1%) dhe maj të vitit 2019 (5.5%). Në mënyrë të ngjashme, vetëm 7% e të anketuarve i shohin si të favorshme kushtet aktuale të punësimit, gjë që paraqet rritje krahasuar me dhjetorin e vitit 2020 (5.6%) dhe prillin e vitit 2020 (6.6%), dhe është vlerë më e lartë se në maj të vitit 2019 (5.8%). Për fund, gjithsej 18.8% e të gjithë të anketuarve i shohin si të favorshme kushtet e ardhshme të punësimit gjashtë muaj pas anketës së opinionit të majit të vitit 2021, gjë që paraqet rritje prej gati 10 pikë përqindjeje krahasuar me dhjetorin e vitit 2020 (8.3%) dhe 7.3 pikë përqindjeje nga prilli i vitit 2020, duke sugjeruar kështu një optimizëm të shtuar në lidhje me punësimin në të ardhmen në Kosovë. Si përmbledhje, komponentët e IBE-së sugjerojnë që pothuajse gjysma e qytetarëve të Kosovës (1.49) kanë pikëpamje optimiste për ekonominë.

**Tabela 3. Analiza e trendeve të komponentëve të IBE-së**

E favorshme	Mars -15	Shta -15	Prill -16	Tet -16	Tet -17	Maj -18	Nën -18	Maj -19	Nën -19	Prill -20	Dhje -20	Maj -21	Trendi
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj gjashtë muaj nga sot?	15.10%	15.90%	23.40%	18.00%	22.40%	19.90%	18.80%	11.60%	13.70%	14.20%	11.50%	15.90%	
Cili është vlerësimi juaj i kushteve aktuale të biznesit?	8.10%	8.30%	14.40%	13.10%	17.90%	18.50%	16.70%	5.50%	9.10%	8.20%	7.20%	4.70%	
Cili është vlerësimi juaj për gjendjen aktuale të punësimit?	5.00%	6.80%	10.30%	7.70%	17.10%	15.40%	15.90%	5.80%	7.40%	6.60%	5.60%	7.00%	
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me kushtet e punësimit gjashtë muaj nga sot?	6.00%	8.00%	14.00%	10.70%	18.70%	17.80%	23.30%	4.60%	12.00%	11.60%	8.30%	18.80%	



# Drejtimi ekonomik

Përmbysja e perceptimeve krahasuar me rënien e dhjetorit të vitit 2020 mund të vërehet edhe në kënaqshmërinë e të anketuarve me drejtimin ekonomik të Kosovës. Në maj 2021, 18.4% e të anketuarve ishin të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës krahasuar me 6.9% në dhjetor 2020, duke qenë vlerë më e lartë edhe se prilli i vitit 2020 (10.7%). Ndërkohë që 53.3% e të anketuarve janë shumë të pakënaqur ose të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, 28.1% nuk janë as të kënaqur as të pakënaqur. Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë tregojnë se meshkujt janë pak më të kënaqur sesa femrat me drejtimin ekonomik të Kosovës. 19.2% e meshkujve janë të kënaqur ose shumë të kënaqur, dhe 17.3% e femrave janë të kënaqura ose shumë të kënaqura me drejtimin ekonomik të Kosovës. Në mënyrë të ngjashme, 55.9% e meshkujve janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, kundrejt 50.2% të femrave që ndihen njësoj. Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike sugjerojnë nivel të ngjashëm të pakënaqësisë si tek shqiptarët e Kosovës ashtu edhe tek serbët e Kosovës, ku shkalla e pakënaqësisë është 51.4%, përkatësisht 52.4%. Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës duket se janë më pak të pakënaqur, duke treguar nivel të pakënaqësisë prej 37.8%. Prandaj, grupi më i kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës janë të anketuarit nga komunitetet e tjera të Kosovës (23.4%), ndjekur nga shqiptarët e Kosovës (20.2%) dhe serbët e Kosovës (4.8%).




Figura 5. Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës

# Problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht

Anketa e Pulsit Publik e majit të vitit 2021 i hulumtoi edhe problemet më madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht. Gjetjet tregojnë ndryshime nga anketa e mëparshme për sa u përket tre çështjeve madhore që ndikojnë në mirëqenien sociale: problemet e hapësirës urbane, që ishin një nga tre problemet madhore në anketën e dhjetorit të vitit 2020, janë zëvendësuar nga korrupsioni. Tre çështjet kryesore madhore të raportuara gjatë anketës së majit të vitit 2021 ishin papunësia (34.3%), varfëria (19.3%) dhe korrupsioni (9.3%), ndërkohë që papunësia, varfëria dhe problemet e hapësirës urbane ishin tre shqetësimet kryesore në dhjetor të vitit 2020. Ndryshimi më i madh mund të vërehet në perceptimin për korrupsionin, ku krahasuar me prillin e vitit 2020, korrupsioni (23.5%) ka rënë me 14.2 pikë përqindjeje. Shërbimet shëndetësore vazhdojnë të jenë problemi i katërt madhor (8.6%), i ndjekur nga problemet e hapësirës urbane (3.8%) dhe problemet mjedisore (3%). Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime madhore mes komuniteteve të ndryshme etnike në renditjen e problemeve madhore. Për shembull, serbët e Kosovës i konsiderojnë papunësinë (16.7%), sigurinë publike dhe personale (14.8%) dhe problemet e hapësirës urbane (12.9%) si tre problemet më të mëdha, ndërsa për komunitetet e tjera të Kosovës problemi më i madh është papunësia (51.2%), e ndjekur nga varfëria (18.9%) dhe furnizimi me energji (11.4%). Për shqiptarët e Kosovës, papunësia (33.7%), varfëria (19.6%) dhe korrupsioni (9.6%) janë tre problemet madhore në Kosovë.

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se meshkujt dhe femrat janë kryesisht të shqetësuar për papunësinë, varfërinë dhe korrupsionin. Sidoqoftë, femrat janë më të shqetësuar për papunësinë dhe varfërinë (përkatësisht 35.8% dhe 22.3%) sesa meshkujt (përkatësisht 32.5% dhe 16.3%), dhe meshkujt janë më pak të shqetësuar për korrupsionin (9.8%) sesa femrat (8.8%).





Figura 6. Perceptimet për problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht

# Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat

Anketa e majit 2021 tregon se 24% e të anketuarve konsiderojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, kurse 76% mendojnë se punësimi në sektorin publik nuk bëhet në baza meritore. Gjetjet tregojnë dallim minimal me anketën e dhjetorit të vitit 2020 kur 21.9% e të anketuarve mendonin se punësimi bëhet në baza meritore dhe 78.1% mendonin se nuk bëhet në baza meritore. Të anketuarit i konsiderojnë faktorët vijues si faktorë kryesorë për të siguruar punësim në sektorin publik: lidhjet partiake (29.3%), lidhjet familjare (21.1%), arsimiti (16.6%), ryshfeti (11.2%), miqtë (11.2%), dhe në masë më të vogël përvoja profesionale (5%), aftësimi profesional (2.7%) dhe dukja (2.7%). Gjithsej 24.3% e të anketuarve besojnë se arsimiti, aftësimi profesional dhe përvoja profesionale janë faktorë të rëndësishëm për sigurimin e punësimit në sektorin publik. Në dhjetor të vitit 2020, kjo shifër ishte 21.9%.


Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë dallime të vogla në perceptimet e meshkujve dhe femrave në lidhje me punësimin në baza meritore. Gjithsej 24.4% e meshkujve besojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, krahasuar me 23.1% të femrave që mendojnë të njëjtën gjë. Si për meshkujt (30.1%) ashtu edhe për femrat (27.1%), lidhjet partiake janë mënyra më e lehtë për punësim në sektorin publik. Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se lidhjet partiake duket se janë faktori kyç për sigurimin e punësimit për shqiptarët e Kosovës (27.2%), serbët e Kosovës (48.1%) dhe komunitetet e tjera të Kosovës (24.4%). Ngjashëm me anketën e opinionit të dhjetorit të vitit 2020, besim më të vogël në punësim në baza meritore kanë serbët e Kosovës (17.5%), pasuar nga shqiptarët e Kosovës (24.4%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës, besimi i të cilëve në punësimin në baza meritore është më i larti, me 33.9% që besojnë se arsimimi, përvoja profesionale dhe aftësimi profesional janë faktorë vendimtarë për sigurimin e punësimit në sektorin publik. Përveç shqiptarëve të Kosovës, besimi në punësimin në baza meritore ka rënë ndjeshëm si tek serbët e Kosovës ashtu edhe tek pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës, krahasuar me anketën e opinionit të dhjetorit 2020, kur 27.6% e serbëve të Kosovës dhe 44% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës deklaruan besimin e tyre në punësimin në baza meritore.



**Figura 7. Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik**

Për dallim nga perceptimi për punësimin në sektorin publik, shumica e të anketuarve (54.4%) besojnë se përvoja profesionale, arsimimi dhe formimi profesional janë faktorë të rëndësishëm për t'u punësuar në sektorin privat. Gjithsej 45.5% e të anketuarve besojnë se punësimi në sektorin privat nuk bëhet në baza meritore. Të anketuarit identifikuan faktorët e mëposhtëm jo meritore për sigurimin e punësimit në sektorin privat: lidhjet familjare (23.5%), miqtë (7.6%), ryshfeti (6.6%), dukja (4.1%) dhe, në masë më të vogël, gjinia dhe lidhja partiake me 1.9% secila.

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se meshkujt kanë pak më shumë besim tek punësimi në baza meritore në sektorin privat sesa femrat. Për shembull, 54.5% e meshkujve dhe 52.6% e femrave besojnë se meritokracia është faktor i rëndësishëm për të siguruar punësim në sektorin privat. Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime domethënëse në perceptimet e grupeve të ndryshme etnike rreth meritokracisë në sektorin privat. Për shembull, 55.6% e shqiptarëve të Kosovës, 37.6% e serbëve të Kosovës, dhe 62.1% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës besojnë se faktorët meritore si përvoja profesionale, arsimi dhe aftësi profesionale janë çelësi për gjetjen e një pune në sektorin të privat në Kosovë.



*Figura 8. Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat*

## Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë

Mesatarisht, 25% e anketuarve pohojnë se perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë. Kjo vlerë përfaqëson një rënie prej 3 pikë përqindjeje nga dhjetori 2020 (28%), por një rritje prej 4.3 pikë përqindjeje krahasuar me prillin 2020 (20.7%), kur Pulsi Publik regjistroi vlerën më të ulët për korrupsionin në shkallë të gjerë. Sidoqoftë, ky rezultat tregon një trend të qëndrueshëm pozitiv në perceptimin për korrupsionin në shkallë të gjerë krahasuar me nëntorin e vitit 2019 (34.4%) dhe majin e vitit 2019 (30.1%).

Ngjashëm me anketën e mëparshme, Policia e Kosovës perceptohet si organizata më së paku e korruptuar, me 14% të qytetarëve që besojnë se në kuadër të saj ekziston prani e korrupsionit në shkallë të gjerë. Në anën tjetër, Agjencia e Privatizimit e Kosovës (AKP) perceptohet si organizata më e korruptuar, me 39.3% të të anketuarve që perceptojnë praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në kuadër të saj. Ndryshimet më të mëdha në perceptime janë vërejtur në institucionet e mëposhtme: Organizatat Ndërkombëtare (15.7% krahasuar me 23.8% në dhjetor të vitit 2020), Administrata Qendrore e Kosovës (23.1% krahasuar me 29.5% në dhjetor të vitit 2020), Bankat (22.9% krahasuar me 28.1% në dhjetor të vitit 2020), Dogana (34.3% krahasuar me

39.2 % në dhjetor të vitit 2020), Komunat (20.4% krahasuar me 24.7% në dhjetor të vitit 2020). Për sektorë dhe organizata të tjera janë regjistruar dallime më të ulëta krahasuar me anketën e dhjetorit të vitit 2020. AKP-ja (39.3%), Dogana (34.3%) dhe Gjykatat (32.5%) janë tre institucionet kryesore me nivelin më të lartë të perceptuar të korrupsionit në shkallë të gjerë. Institucionet dhe sektorët me vlerat më të ulëta të korrupsionit të perceptuar në shkallë të gjerë janë Policia e Kosovës (15.3%), Arsimi (15.1%) dhe Organizatat Ndërkombëtare (15.7%).

**Tabela 4. Perceptimet për përhapjen e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë**

	Mars -15	Shta -15	Prill -16	Tet -16	Tet -17	Maj -18	Nën -18	Maj -19	Nën -19	Prill -20	Dhje -20	Maj -21	Trendi
Shëndetësia (spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare)	52.60%	51.50%	37.90%	49.70%	25.50%	32.50%	25.70%	25.10%	33.40%	11.00%	25.00%	22.90%	
KEDS	44.70%	35.60%	31.10%	31.40%	20.50%	33.00%	31.30%	40.70%	38.90%	27.30%	28.70%	26.10%	
KEK											27.50%	25.30%	
Gjykatat	42.90%	46.90%	42.30%	49.30%	24.90%	38.60%	29.10%	30.70%	42.00%	24.50%	31.60%	32.50%	
Doganat	38.70%	41.30%	32.30%	45.20%	22.70%	39.10%	31.40%	29.30%	41.40%	30.60%	39.20%	34.30%	
Administrata qendrore/qeveria	38.50	36.00%	36.60%	49.20%	30.70%	34.70%	28.40%	36.70%	35.30%	20.80%	29.50%	23.10%	
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	37.10%	38.30%	39.20%	45.70%	24.90%	34.50%	29.80%	40.70%	48.10%	36.60%	39.00%	39.30%	
Komunat (qeverisja lokale)	33.80%	28.60%	30.00%	40.20%	25.50%	29.00%	26.40%	25.80%	29.80%	13.30%	24.70%	20.40%	
Arsimi (shkollat, Universiteti)	29.30%	29.00%	17.50%	31.00%	16.30%	26.20%	19.90%	20.70%	26.10%	13.60%	19.50%	15.10%	
ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)	28.10%	25.00%	18.20%	32.50%	17.40%	28.90%	25.40%	35.30%	42.20%	18.90%	30.20%	27.40%	
PTK	25.90%	25.20%	18.40%	29.60%	17.00%	27.80%	25.60%	44.20%	40.80%	37.90%	33.20%	31.60%	
Bankat	24.30%	23.30%	23.10%	24.40%	13.10%	27.30%	26.10%	33.80%	34.10%	18.90%	28.10%	22.90%	
Organizatat Ndërkombëtare	20.40%	22.90%	16.00%	28.00%	10.80%	24.50%	10.70%	19.50%	23.60%	5.50%	23.80%	15.70%	
Policia e Kosovës (PK)	20.40%	19.00%	13.60%	21.10%	14.90%	25.70%	21.60%	17.00%	20.70%	9.80%	15.30%	14.00%	

Për t'a kuptuar se çka i formon perceptimet për praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, të anketuarit u pyetën për arsyet e vlerësimit të tyre për përhapjen e korrupsionit. Ngjashëm me anketat e tjera në të shkuarën, gjetjet tregojnë se shumica e të anketuarve (64.5%) i kanë formuar opinionet e tyre përmes

mediave të shkruara dhe elektronike, siç ilustron në Figurën 9 më poshtë. Gjithsej 28.2% e të anketuarve deklaruan se bisedat me të afërmit dhe miqtë e formojnë bazën e opinionëve të tyre në lidhje me përhapjen e korrupsionit, ndërsa 7.1% e të anketuarve pohuan se në opinionet e tyre kanë ndikuar përvojat personale kur atyre iu janë kërkuar para, dhurata ose favore të tjera në këmbim të shërbimeve të caktuara.




Figura 9. Arsytet e të anketuarve për vlerësimin e tyre për përhapjen e korrupsionit në Kosovë



## Qëndrimet kundrejt votimit

Anketa e Pulsit Publik e majit 2021 i hulumtoi edhe qëndrimet e qytetarëve të Kosovës ndaj votimit. Qëndrimet ndaj votimit kanë ndryshuar krahasuar me anketën e opinionit të dhjetorit të vitit 2020, duke treguar një rritje të besimit në efektin e votës së popullit për të shkaktuar ndryshime politike. Në pyetjen nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, 43.8% e të anketuarve deklaruan se vota e tyre mund të sjellë ndryshime, krahasuar me 34.1% në dhjetor të vitit 2020 dhe 46.7% në prill të vitit 2020. Nga ana tjetër, 25.1% konsiderojnë se vota e tyre nuk mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, krahasuar me 27.4% në dhjetor të vitit 2020 dhe 26.8% në prill të vitit 2020. Trendi tregon se është rritur ndjeshëm besimi i qytetarëve në votën e tyre krahasuar me majin e vitit 2019 dhe nëntorin e vitit 2018, kur 49% përkatësisht 46% e të anketuarve besonin se vota e tyre nuk mund të ndikojë në ndryshime. Në maj, të vitit 2021, 32.3% konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën deri në një farë mase, ndërsa vetëm 6.4% nuk e dinë nëse vota e tyre mund të sjellë ndryshime ose refuzuan të përgjigjen.





Figura 10. Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë


Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë tregojnë se femrat janë më skeptike sesa meshkujt kur është fjala për ndikimin e votës së tyre. Ndërkohë që 47.2% për qind e meshkujve konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, vetëm 40.6% e femrave e mendojnë të njëjtën gjë. Sidoqoftë, vlen të përmendet se besimi i femrave në fuqinë e votës së tyre është rritur ndjeshëm krahasuar me dhjetorin e vitit 2020, kur ishte në vlerën e ulët prej 28%.



**Figura 11. Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë**


Të dhënat e zbrërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime të konsiderueshme në besimin në zgjedhje si një mekanizëm për të sjellë ndryshime në Kosovë. Vetëm 2.4% e serbëve të Kosovës (8.1% në dhjetor të vitit 2020) konsiderojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime në Kosovë, kundrejt 16.9% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (26.5% në dhjetor të vitit 2020) dhe 48.2% të shqiptarëve të Kosovës (35.5% në dhjetor të vitit 2020). Ndërkohë që gjithsej 47.3% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime (37% në dhjetor 2020), të njëjtën gjë e mendonin edhe 34.8% e serbëve të Kosovës (42.4% në dhjetor të vitit 2020) dhe 22.9% e shqiptarëve të Kosovës (25.8% në dhjetor të vitit 2020).

Përqindja aktuale e serbëve të Kosovës që nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime është më e ulët se në dhjetor të vitit 2020 (42.4%), prill të vitit 2020 (61%) dhe nëntor të vitit 2019 (61.5%). Sidoqoftë, numri i serbëve të Kosovës që besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime deri në një farë mase është më i larti (40.5%), pasuar nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (24.9%) dhe shqiptarët e Kosovës (23.1%).




**Figura 12. Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë**

Anketa e Pulsit Publik e majit 2021 kreu hulumtime edhe për gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e tyre për votim. Gjetjet tregojnë se 75.3% e të anketuarve (krahasuar me 80.9% në dhjetor 2020, 70.2% në prill 2020, 62% në nëntor 2019 dhe 73.5% në maj 2019) do të votonin për një parti të caktuar politike ose një koalicion, nëse zgjedhjet qendrore do të zhvilloheshin në të ardhmen e afërt. Ndërkohë që 7.4% e të anketuarve nuk kishin ndonjë preferencë politike (krahasuar me 9.2% në dhjetor 2020 dhe 13.9% në prill 2020), 10% e të anketuarve thanë se nuk do të votonin (7.5% në dhjetor 2020, 7.4% në prill 2020, 7.8% në nëntor 2019 dhe 11.4% në maj 2019), kurse 7.3% refuzuan të përgjigjen.



**Figura 13. Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse zgjedhjet qendrore mbahen së shpejti**


Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë një rënie të gjasave për votim tek të dyja gjinitë, si dhe dallime të vogla mes meshkujve dhe femrave në lidhje me gjasat e tyre për të votuar nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti (83.7% e meshkujve dhe 82% e femrave krahasuar me 93.4% të meshkujve dhe 92.2% të femrave në dhjetor të vitit 2020). Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike sugjerojnë rënie të gjasave për të votuar mes të gjitha grupeve të Kosovës, krahasuar me anketën e dhjetorit 2020. Gjegjesisht, 42.9% e serbëve të Kosovës do të votonin tani, krahasuar me 59.1% në dhjetor të vitit 2020 dhe 68.1% në prill të vitit 2020. Gjithsej do të votonin 77.3% e shqiptarëve të Kosovës, krahasuar me 84.4% në dhjetor të vitit 2020 dhe 69.8 në prill të vitit 2020, dhe të njëjtën gjë do ta bënin 70.2% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, krahasuar me 89.4% në dhjetor të vitit 2020 dhe 71% në prill të vitit 2020. Gjithsej 5.8% e shqiptarëve të Kosovës (9.2% në dhjetor të vitit 2020), 14.8% e serbëve të Kosovës (16.7% në dhjetor të vitit 2020), dhe 9.5% e komuniteteve të tjera të Kosovës (5% në dhjetor të vitit 2020) nuk kishin preferenca politike, ndërsa 9.6% e shqiptarëve të Kosovës, 22.9% e serbëve të Kosovës, dhe 9.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës deklaruan se nuk do të votonin nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti.



**Figura 14. Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, të dhëna të zbërthyer sipas përkatësisë etnike**


# Mjedisi

Të anketuarit u pyetën për njohuritë e tyre në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Anketa e Pulsit Publik e majit të vitit 2021 nxjerrë në pah dallime të konsiderueshme krahasuar me dhjetorin e vitit 2020 kur flitet për qytetarët që pohojnë se kanë më shumë njohuri në lidhje me të drejtën për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Gjithsej 16.1% (8.2% në dhjetor 2020) thanë se dinë shumë për këtë temë, 32.7% (27.4% në dhjetor 2020) pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 36% e të anketuarve (37% në dhjetor 2020) thanë se dinë pak për këtë temë. Gjithsej 15.2% (27.4% në dhjetor 2020) thanë nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.




**Figura 15. Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër**

Të dhënat e zberthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime thelbësore mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë në lidhje me vetëdijesimin e tyre për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Gjithsej 35.8% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, 33.8% e serbëve të Kosovës dhe 12.4% e shqiptarëve të Kosovës deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë çështje, gjë që paraqet rritje (përveç tek shqiptarët e Kosovës) tek grupet jo shumicë në krahasim me dhjetorin e vitit 2020 (27.1% e serbëve të Kosovës dhe 25.5% e komuniteteve të tjera të Kosovës). Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve (35.8%) që deklaruan se nuk kanë njohuri mbi këtë temë. Shqiptarët e Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve me njohuri të vogla dhe mesatare në lidhje me temën (përkatësisht 37.9% dhe 33.3%). Shqiptarët e Kosovës udhëheqin edhe në njohuritë e shumta për këtë temë, pasuar nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (10.9%) dhe serbët e Kosovës (3.8%).



**Figura 16. Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike**

Një pyetje tjetër për mjedisin ishte e ndërlidhur me vetëdijesimin e të anketuarve rreth kërcënimeve të mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Ndërkohë që 11.9% (6.8% në dhjetor 2020) e të anketuarve deklaruan vetëdijesim të plotë në lidhje me këto kërcënime, 70.7% (65.8% në dhjetor 2020) e të anketuarve deklaruan se kanë njohuri të vogla deri në mesatare rreth këtyre kërcënimeve dhe 17.4% (27.4% në dhjetor 2020) e të anketuarve deklaruan se nuk kanë njohuri në lidhje me kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë 3 pikë përqindjeje në favor të meshkujve për sa i përket njohurive mbi këtë temë (13.5% e meshkujve dhe 10.4% e femrave), si dhe gjetjen se janë më të paktë meshkujt sesa femrat që nuk kanë njohuri në lidhje me këtë temë (15.8% e meshkujve dhe 18.9% e femrave). Të dhëna të tjera të zbërthyera sipas gjinisë nuk tregojnë dallime madhore mes femrave dhe meshkujve.



**Figura 17. Vetëdija e të anketuarve për kërcënimet potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre**

Siç shihet në Figurën 18, të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike nxjerrin në pah dallimet mes njohurive të grupeve etnike në lidhje me kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Gjithsej 35.7% e serbëve të Kosovës, 28.9% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 11.2% e shqiptarëve të Kosovës nuk kanë njohuri për këtë temë. Dallimi më i madh mes dhjetorit 2020 (26.7%) dhe majit 2021 (11.2%) është rënia e numrit të shqiptarëve të Kosovës që nuk kanë njohuri për këtë temë. Serbët e Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve që deklaruan se nuk kanë njohuri për temën (35.7%). Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të atyre që kanë pak njohuri (36.8%), ndërsa shqiptarët e Kosovës janë të parët për zotërimin e njohurive mesatare (32.8%) për temën. Shqiptarët e Kosovës janë gjithashtu të parët për zotërimin e njohurive të shumta në lidhje me këtë çështje (20.2% krahasuar me 7.1% në dhjetor 2020), pasuar nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (9% krahasuar me 2.5% në dhjetor 2020) dhe serbët e Kosovës (3.8% krahasuar me 6.2% në dhjetor 2020).





Figura 18. Vetëdija e të anketuarve për kërcënimet potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, të dhëna të zërthyer sipas përkatësisë etnike

## COVID-19


Për t'i krahasuar tendencat nga viti 2020, anketa e Pulsit Publik e majit 2021 përmbante edhe pyetje në lidhje me pandeminë COVID-19. Të anketuarit u pyetën së pari rreth ndikimit të COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike, shëndetin fizik dhe shëndetin mendor. Gjithsej 60.7% e të anketuarve (68.7% në dhjetor 2020 dhe 65.9% në prill 2020) deklaruan se COVID-19 ka pasur ndikim negativ në mirëqenien e tyre ekonomike, 46.9% (46.9% në dhjetor 2020 dhe 40.7% në prill 2020) deklaruan se ka ndikuar negativisht në shëndetin e tyre fizik; dhe 52.8% (52.8% në dhjetor 2020 dhe 59% në prill 2020) treguan se ka ndikuar në shëndetin e tyre mendor. Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë nuk tregojnë ndonjë ndryshim të madh në ndikimin e COVID-19 në mirëqenien ekonomike të femrave (59.8%) dhe meshkujve (60.8%). Nuk mund të vërehet asnjë ndryshim i madh mes femrave (47.2%) dhe meshkujve (48.5%) në ndikimin e COVID-19 në shëndetin mendor, ndërsa ndikimi i COVID-19 në shëndetin fizik është më i lartë tek meshkujt (45.2%) sesa tek femrat (41.4%). Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë tregojnë një rënie të efekteve negative të COVID-19 si tek femrat ashtu edhe tek meshkujt për sa i përket mirëqenies ekonomike, shëndetit mendor dhe shëndetit fizik.





**Figura 19. Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor**

Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se ndikimi i COVID-19 në mirëqenien ekonomike ka qenë thelbësor tek të anketuarit nga të gjitha komunitetet etnike; gjithsej 61.3% e shqiptarëve të Kosovës, 48.1% e serbëve të Kosovës dhe 58.2% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës raportuan ndikim negativ të COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike. Gjithsej 34.4% e shqiptarëve të Kosovës, 18.6% e serbëve të Kosovës dhe 32.3% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës deklaruan se shpërthimi i pandemisë COVID-19 nuk kishte pasur asnjë efekt në mirëqenien e tyre ekonomike. Ndërkohë që 42% e shqiptarëve të Kosovës raportuan se COVID-19 ka pasur ndikim negativ në shëndetin e tyre fizik, të njëjtën gjë e raportuan edhe 43.8% e serbëve të Kosovës dhe 37.8% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Në të njëjtën kohë, 47.3% e shqiptarëve të Kosovës, 47.1% e serbëve të Kosovës dhe 43.8% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës raportuan ndikim negativ të COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike. Si përmbledhje, këto shifra sugjerojnë se situata e krijuar nga shpërthimi i COVID-19 në Kosovë ka pasur efekte të mëdha negative në mirëqenien ekonomike të të anketuarve, përcjellur nga efektet në shëndetin mendor dhe shëndetin fizik.



**Figura 20. Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor, të dhëna të zërthyera sipas përkatësisë etnike**

Të anketuarit u pyetën edhe nëse janë të kënaqur me masat e marra nga institucionet publike të Kosovës për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Të dhënat sugjerojnë kënaqshmëri mesatare dhe përmbyse të perceptimeve krahasuar me dhjetorin e vitit 2020, me një numër më të lartë të të anketuarve (43.6%) të kënaqur me masat e marra nga kabineti ekzekutiv, në krahasim me dhjetorin 2020 kur shumica e të anketuarve (58%) ishin të pakënaqur me masat e kabinetit ekzekutiv të Kosovës, me vetëm 15.6% të kënaqur. Përkundër kësaj rritjeje në kënaqshmëri, shkalla e kënaqshmërisë në maj të vitit 2021 është më e ulët se ajo e prillit 2020, kur 78.8% e shprehën kënaqshmërinë me reagimin e kabinetit ekzekutiv të Kosovës ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19. Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë nuk tregojnë dallime të mëdha mes femrave (43.6%) dhe meshkujve (43.2%) për sa i përket kënaqshmërisë me masat e marra nga kabineti ekzekutiv për ta parandaluar përhapjen e pandemisë. Vlen të përmendet se në anketën e prillit 2020, shkalla e kënaqshmërisë ishte shumë më e lartë, teksa shumica e femrave (81.5%) dhe meshkujve (76%) ishin shumë të kënaqur me reagimin e kabinetit ekzekutiv të Kosovës ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19.




Figura 21. Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19

Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike nxjerrin në pah edhe kënaqshmërinë mesatare me masat e ndërmarra nga kabineti ekzekutiv, duke dalluar nga luhatjet madhore të kënaqshmërisë mes prillit dhe dhjetorit 2020. Gjithsej 44.6% e shqiptarëve të Kosovës janë të kënaqur me masat e kabinetit ekzekutiv, pasuar nga 40.8% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, ndërsa vetëm 5.7% e serbëve të Kosovës kanë shprehur kënaqshmërinë e tyre me masat e ndërmarra nga kabineti ekzekutiv i Kosovës. Gjithsej 25.1% e shqiptarëve të Kosovës janë të pakënaqur, të ndjekur nga 39.1% e serbëve të Kosovës dhe 28.4% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera në Kosovë.




Figura 22. Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19, të dhëna të zërthyer sipas përkatësisë etnike

# Metodologjia

Gjetjet e paraqitura në këtë përmbledhje bazohen në një anketë të opinionit me 1,307 qytetarë të Kosovës të moshës mbi 18 vjeçare, të realizuar nga data 12 deri më 25 maj 2021. Mostra përfshiu numër të njëjtë të meshkujve dhe femrave nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke i mbuluar zonat urbane dhe rurale. Në aspektin e përfaqësimit etnik, mostra ka përfshirë 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 201 pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës (boshnjakë të Kosovës, ashkali të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës). Anketa u krye në bazë të mostrimit me probabilitet rastësor në etapa të shumëfishta, dhe u krye përmes intervistave sy më sy. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë.<sup>6</sup>

## Peshimi i totaleve të popullatës

Anketat e Pulsit Publik marrin mostra më të mëdha të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të zërthehen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë, kur bëhen përlogaritjet për totale, ekipi i Pulsit Publik bën peshimin e të dhënave sipas shifrave aktuale të popullatës. Që nga viti 2002, janë përdorur përqindjet e mëposhtme për peshimin e totaleve të popullsisë:

- **Shqiptarë të Kosovës: 88%;**
- **Serbë të Kosovës: 6%;**
- **Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: 6%.**

Sipas regjistrimit të popullsisë të kryer në vitin 2011 dhe të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike aktuale në Kosovë është siç vijon:

Përkatësia etnike	Gjithsej popullsia	Përqindja e popullsisë së përgjithshme
Shqiptarë të Kosovës	1,616,869	92.93
Serbë të Kosovës	25,532	1.47
Turq të Kosovës	18,738	1.08
Boshnjakë të Kosovës	27,533	1.58
Goranë të Kosovës	10,265	0.59
Romë të Kosovës	8,824	0.51
Ashkali të Kosovës	15,436	0.89
Egjiptas të Kosovës	11,524	0.66
Të tjerët, refuzuan të deklarojnë dhe nuk janë në dispozicion	5,104	0.29
Gjithsej	1,739,825	100.00

<sup>6</sup> Në raport përdoren termat përqindje dhe pikë përqindjeje. Një pikë përqindjeje është ndryshimi numerik mes dy përqindjeve; ndërsa përqindja është raporti i shprehur si fraksion i 100-shit. Përqindja i referohet shkallës së ndryshimit, ndërsa pika e përqindjes mat sasinë reale të ndryshimit.

Nëse këto shifra do të ndiqeshin për Anketat e Pulsit Publik, peshimi do të ishte si më poshtë:

- **Shqiptarë të Kosovës: 93%;**
- **Serbë të Kosovës: 2%;**
- **Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: 5%.**

Megjithatë, duke e marrë parasysh se serbët e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, së bashku me vlerësimin e përgjithshëm se shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, u vlerësua se duhet t'i shtojmë edhe 34,000 serbë të tjerë të Kosovës, duke e sjellë në 59,532 numrin total të serbëve të Kosovës të konsideruar për qëllimet e këtij studimi. Ky veprim gjithashtu e rriti popullsinë e përgjithshme të Kosovës në 1,773,825. Kur merren në konsideratë këto ndryshime, peshimi në anketat e Pulsit Publik është bërë si në vijim:

- **Shqiptarë të Kosovës: 92%;**
- **Serbë të Kosovës: 4%;**
- **Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: (ashkali të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës): 4%.**

## Përlllogaritja e Indekseve

Indeksi i Demokratizimit është një mesatare e përbërë e bazuar në nivelin e pajtimit apo mospajtimit të të anketuarve me zhvillimet vijuese në Kosovë: shkalla e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, monitorimi i Kuvendit, performanca e institucioneve qendrore, pavarësia e sistemit gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, Kushtetuta dhe ligjet e bazuara në të drejtat e njeriut, dhe nëse qeveritë lokale punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. ID-ja është matje e vazhdueshme e cila shkon nga 0 në 3, ku rezultati prej 0 do të thotë që asnjë nga anketuarit nuk konsideron që demokratizimi është në rrugën e duhur, ndërsa rezultati prej 3 do të thotë që të gjithë të anketuarit pajtohen plotësisht se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike është një mesatare e përbërë e cila përlllogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve për kushte të favorshme ose të pafavorshme ekonomike në Kosovë. Konkretisht, të anketuarit i vlerësojnë kushtet në vijim: pritjet në lidhje me të hyrat totale të familjeve të tyre, kushtet e punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, dhe vlerësimin e kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. IBE-ja është një matje e vazhdueshme me vlera që shkojnë nga 0 në 3, ku harku prej 0 deri në 1.5 tregon një vlerësim të pafavorshëm të gjendjes ekonomike nga shumica e popullatës, kurse harku prej 1.5 deri në 3 tregon një vlerësim të favorshëm nga shumica.







**USAID**

NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



# PULSI PUBLIK

## XX

13.145343

Maj 2021

15.756789

11

9.456346

4.566456

56736

